



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 35721 Prot.
7

Patos më 04.10.2024.

PROCESVERBAL

MBI MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS SË MBLEDHJES SË DATËS 30.09.2024

I mbajtur sot më datë 30.09.2024 në orën 14:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit ku zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë:

Prezent në fillimin e mbledhjes këta këshilltare:

1. Albiona Lamaj
2. Klaudio Alisininaj
3. Liljana Mestuaj
4. Erald Çepele
5. Lori Musaj
6. Artan Velçani
7. Armand Ahmetaj
8. Ertila Myrtaj
9. Smerald Hazizaj
10. Vjollca Kasaj
11. Novrus Toska
12. Eduart Faslliaj

Takimi hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj.

Armand Ahmetaj – Përshëndetje të gjithëve!

Të nderuar koleg këshilltarë!!

Kjo është mbledhja e radhës e këshillit bashkiak. Mbledhja është e bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Rendi i ditës ju është përcjell të gjithëve nëpërmjet emailit, keni ndonjë diskutim mbi rendin e ditës? Ndonjë pyetje mbi rendin e ditës? Ndonjë shtim apo heqje të ndonjë pike? Nëse nuk keni mendoj të kalojmë në leximin dhe miratimin e rendit të ditës.

1- Miratimi i rendit të ditës.

2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 17.09.2024.

3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 17.09.2024.

4- Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Gusht 2024”.

5- Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Gusht 2024”.

6- Projekt-vendim "Për miratimin e akt marrëveshjes së bashkëpunimit që do të lidhet midis Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe Bashkisë Patos në zbatim të VKM nr. 435, datë 26.06.2024 "Për një shtesë në VKM 867, datë 10.12.2014 "Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore".

7- Projekt-vendim "Për një shtesë në buxhetin e vitit 2024 miratuar me VKB nr. 81 datë 18.12.2023".

8- Projekt-vendim "Për ndryshimin e vendimit nr. 74 datë 30.11.2023 "Mbi miratimin e nivelit të pagave të bashkisë, institucioneve në vartësi, njësive administrative, dhe funksioneve të transferuara për vitin 2024".

9- Projekt-vendim "Për një shtesë në VKB nr. 65 datë 17.09.2024 "Për miratimin e listës së familjeve në nevojë që përfitojnë rikonstruksion banese nga sistemi i pikëzimit".

10- Informacion mbi raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për 4-mujorin e dytë të vitit 2024.

Dua t'ju njoftoj se rendi i ditës është hartuar konform procedurave të miratuara dhe të shprehura në rregullore.

Armand Ahmetaj- Kush është dakord?

Miratohet me 13 vota pro abstenim ska, kundër ska. Dua tju njoftoj se janë shtuar dhe 2 këshilltarë **znj. Klarida Semanjaku dhe z. Renaldo Shpata**


14 vota Pro. abstenim ska, kundër ska

SEKRETARE

Refaela Xeba




Renaldo Shpata 

Flordio Alsinonj 

Eduort Folliof 

KRYETAR

Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3574 Prot. 18

Patos më 09.10.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.09.2024 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 17.09.2024.

Armand Ahmetaj - Nëse ka ndonjë propozim, sygjerim për korrigjim procesverbali?

Nëse ska pyetje atëherë deklarohet i miratuar.

SEKRETARE

Refaela Xeba

Renaldo Shyete

Klaudon Alsinangj

Edmond Foshtaj

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 35721 Prot.
19

Patos më, 09 10.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.09.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës.

Mbi informacionin për vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 17.09.2024

Armand Ahmetaj– Fjala për Refaelën!

Refaela Xeba- Përshëndetje të gjithëve! Në mbledhjen e datës 17.09.2024 janë marrë gjithsej 5 vendime. Nga nr. 61 deri në nr 65.

Vendimet janë zbardhur në afat dhe i janë përcjell drejtorive përkatëse për ekzekutim.

Nga këto vendime 3 ishin me karakter normativ të cilat i janë përcjell Prefekturës për verifikim të ligjshmërisë dhe akoma nuk na ka ardhur pergjigja.

Faleminderit!

SEKRETARE

Refaela Xeba

Renaldo Ilye
Klaudis Alsinony
Eduard Fosllioy

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3466/3 Prot.

Patos më 04.10.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.09.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së katërt të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Gusht 2024.

Pikë e cila ka kaluar paraprakisht në komisionin e Ekonomisë, Financës në datën 27.09.2024.

Ekzekutivi Relaton - Barie Goxhaj

Për të ardhurat e Bashkisë për muajin Gusht 2024 zyra propozon të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e buxhetit vendor 14 familje me një fond prej 62,629 (gjashtëdhjetë e dymijë e gjashtëqind e njëzetë e nëntë) lekë.

Familjet përfituese sipas relacioni bashkëngjitur bashkë me shumat përkatëse.

Lori Musaj- Përshëndetje të gjithëve! Ky projektvendim ka kaluar për shqyrtim në komisionin e ekonomisë në datën 27.09.2024. Është argumentuar në përputhje me ligjin dhe ne e kemi votuar me katër vota pro.

Armand Ahmetaj –Atëherë kemi diskutime, pyetje?

Atëherë meqenëse nuk ka propozoj ta kalojmë në votim. Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Gusht 2024”.

Kush është dakord për pikën e katërt?

Miratohet me 14 vota pro, kundër ska, abstenim ska.

SEKRETARE

Refaela Xeba

Renaldo Shybo
Iludis Alsinovaj
Edmond Foschij

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 34671 Prot.

Patos më 09 10.2024.

3

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.09.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së pestë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Gusht 2024”.

Ekzekutivi Relaton - Barie Goxhaj

Nga fondet e kushtëzuara 6% janë gjithsej 18 familje me një fond prej 63,159 (gjashtëdhjetë e tremijë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë.

Lori Musaj- Përshëndetje të gjithëve! Edhe kjo pikë ka kaluar për shqyrtim në komisionin dhe ne e kemi votuar me katër vota pro.

Armand Ahmetaj – kemi diskutime të tjera?

Atëherë propozojë të kalojmë në votimin e pikës së pestë Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Gusht 2024”.

Kush është dakord?

Miratohet me 14 vota pro, abstenim ska, kundër ska

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj

Renelolo Shpate
Jekandb Hoxhaj
Eduarit Foshtaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3555/3 Prot.

Patos më 04.10.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.09.2024 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së gjashtë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e akt marrëveshjes së bashkëpunimit që do të lidhet midis Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe Bashkisë Patos në zbatim të VKM nr. 435, datë 26.06.2024 “Për një shtesë në VKM 867, datë 10.12.2014 “Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore”.

Armand Ahmetaj- Ftojmë ekzekutivin.

Nurka Hazizaj- Në kuadër të trajtimit me prioritet dhe përfundimit të procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje në zbatim të legjislacionit për përfundimin e proceseve kalimtare në Republikën e Shqipërisë u miratua VKM nr. 435, datë 26.06.2024 “Për një shtesë në VKM nr. 867, datë 10.12.2014 “Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore”, marrëveshja e bashkëpunimit (tip).

Kjo marrëveshje do të nënshkruhet midis Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe Bashkisë Patos.

Ka si qëllim bashkërendimin e të gjithë punës për përfundimin e procesit të legalizimit të objekteve pa leje në zona me prioritet zhvillimi urban, për të cilat janë miratuar dokumente të planifikimit të territorit, si dhe për zona informale në të cilën ka një numër të konsiderueshëm ndërtime pa leje. Kryesisht i jepet prioritet banesave dhe më pas gjithë objekteve që janë ndërtuar pa leje.

Me shkresën nr. 10812/1 prot., datë 10.06.2024 pranë bashkisë Patos nga ASHK është depozituar marrëveshja për nënshkrim nga ASHK.

Para nënshkrimit të marrëveshjes nga kryetari kërkohet parimisht miratimi nga këshilli i Bashkisë Pasi u shqyrtua përmbajtja e gjithë aktit të parashikuar në këtë marrëveshje i kërkohet Këshillit të Bashkisë në bazë të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, nr. 111/2018 “Për kadastrën”, ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar.

Të miratojë akt marrëveshjen e bashkëpunimit, që do të lidhet midis Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe Bashkisë Patos në zbatim të VKM-së nr. 435, datë 26.06.2024 “Për një shtesë në VKM-në nr. 867, datë 10.12.2014 “Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore”, pjesë përberëse e këtij projektvendimi është marrëveshja tip.

Klaudio Alisininaj- Përshëndetje!

Ne e diskutuam dhe në komisionin e ligjeve ku u mbledhëm në datën 26 dhe pasi e shqyrtuam pikën e miratuam me 4 vota pro.

Numri i këshilltarëve është shtuar me z. Gani Ahmetaj.

Armand Ahmetaj – Nëse s’kemi diskutim tjetër unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e gjashtë, Projekt-vendim “Për miratimin e akt marrëveshjes së bashkëpunimit që do të lidhet midis Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe Bashkisë Patos në zbatim të VKM nr. 435, datë 26.06.2024 “Për një shtesë në VKM 867, datë 10.12.2014 “Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore”.

Kush është dakord?

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 15 vota pro.

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR


Armand Ahmetaj



Remaldo Shyqete

Flandro Arsimaj

Eduort Forcing





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3569/3 Prot.

Patos më 09.10.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.09.2024 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së shtatë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për një shtesë në buxhetin e vitit 2024 miratuar me VKB nr. 81 datë 18.12.2023”.

Mimoza Shtëmbari- Projekt-vendimi “Për një shtesë në buxhetin e vitit 2024 miratuar me VKB nr. 81 datë 18.12.2023”, ka të bëjë me zbatimin e të gjitha procedurave për miratimin e shtesës së buxhetit për vitin aktual. Shtesa konsiston me zbatimin e VKM nr. 503, në gusht të 2024 për përballimin e efektit financiar që vjen nga ndryshimi i niveleve të pagave për punonjësit e shërbimit civil në bashki. Qeveria ka alokuar për bashkinë Patos një vlerë prej 9 milion 731 mijë lekë për përballimin e efektit financiar që mbulon vetëm diferencën midis efektit aktual dhe kufirit minimal të VKM-së. E gjithë kjo shtesë është paraqitur si shtesë buxheti dhe do të kalojë si shtesë të shpenzimeve të personelit. E ndarë në shpenzime për pagat dhe shpenzime për sigurimet shoqërore. Projektvendimi që vjen më pas për miratimin e nivelit të pagave nga llogaritja vjen me një efekt financiar me 11 milion e 500 mijë ku 9 milion e 731 mijë do të mbulohen nga kjo shtesë buxheti dhe diferenca do të mbulohet nga fondi i kontigjencës i miratuar në buxhetin e vitit 2024. Shoqëruar me projektvendimin është edhe tabela.

Lori Musaj- Edhe ky projektvendim kaloi në komisionin e ekonomisë me katër vota pro dhe ftoj kolegët ta miratojnë.

Armand Ahmetaj – Nëse s’kemi diskutim tjetër unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e shtatë Projekt-vendim “Për një shtesë në buxhetin e vitit 2024 miratuar me VKB nr. 81 datë 18.12.2023 . Kush është dakord? Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 15 vota pro.

SEKRETARE
Refaela Xeba

KRYETAR
Armand Ahmetaj

Renelata Shpreha
Edmond Alsinona
Eduard Ferling



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2083/4 Prot.

Patos më 04.10.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.09.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për ndryshimin e vendimit nr. 74 datë 30.11.2023 “Mbi miratimin e nivelit të pagave të bashkisë, institucioneve në vartësi, njërive administrative, dhe funksioneve të transferuara për vitin 2024”.

Juela Shpata - Bashkia Patos për efekt të zbatimit të akteve ligjore të ndryshuara në lidhje me nivelin e pagave për të gjithë kategoritë e punonjësve dhe nëpunësve të Bashkisë Patos dhe Agjencisë së Shërbimeve Publike, paraqet këtë relacion.

Referuar dy VKM-ve bazë në të cilën trajtohet niveli i pagave në administratën e bashkisë Patos.

V.K.M-në nr. 503, datë 01.08.2024 për disa ndryshime në V.K.M-së nr. 328, datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njërive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil e të punësuarve administrative të njërive të vetëqeverisjes vendore”

Bashkia Patos në kuadër të ndryshimeve të kategorive dhe kufijve të nivelit të pagave sipas V.K.M-së sipërpërmendur dhe lidhjes nr. 1 dhe nr. 2 bashkëlidhur projektvendimit paraqet ndryshimet:

Për funksionarët e zgjedhur, të emëruar, nëpunësit civil pagat për pozicion janë paraqitur, duke filluar nga kategoria I-5, që përcakohet Sekretari i Përgjithshëm II-2, drejtor drejtorie III-2, Përgjegjës me diplomë master shkencor III-3, përgjegjës me diplomë master profesional, dhe specialist IV-3, IV-4, në katër nivele; nga niveli dysheme deri tek niveli maksimal sipas performancës dhe nivelit të diplomës, referuar V.K.M-ve të sipërpërmendura.

Gjithashtu propozojmë ndryshim në nivelin e pagave dhe shoferave manovratorëve referuar shkronjës “m” në VKM nr. 422 datë 26.06.2024.

Efekti financiar nga zbatimi i V.K.M të sipërpërmendura në total në total është 11, 531, 030 lekë, i cili do të mbulohet nga alokimi shtesë i grantit dhe nga fondi i kontigjencës.

Gjithashtu, shtesa për vjetërsi në punë do të mbulohet nga fondi i pagave të planifikuara për vitin 2024, sipas 3 klasifikimeve të bëra në VKM nr. 503.

Lori Musaj- Edhe kjo pikë e diskutuam me ekzekutivin në komisionin e ekonomisë. Është kënaqësi që pagat e bashkisë kanë arritur këto nivele besoj të kënaqshme.

Ne e kemi votuar me katër vota pro.

Erald Çepele- Unë dua ta përshëndes vendimin e qeverisë për rritjen e pagave. Kam vetëm dy gjëra të vogla që dua ti ngre këtu lidhur me rritjen e pagave.

E para është që specialistit urbanist dhe i lejeve i cili është 42 000 mijë lekë, duke qënë dhe me arsim të lartë dhe ndërkohë që tekniku i mesëm është 47 000 mijë lekë. Është lapsus kjo apo nuk është prekur fare. Mendoj që edhe ky specialist mos të diferencohet.

Sigurisht që për eskavatoristët është dicka e mirë, unë do të doja diçka më tepër. Dhe pjesa tjetër që më shqetëson është paga e speciastëve në Zharrëz që nuk është barazuar me specialistët e tjerë, dhe konkretisht specialisti i Shërbimit Social dhe sekretari arkivës dhe specialisti i të ardhurave vendore e kane nga 55 mijë lekë. Jam i mendimit të shkoj 60 mijë lekë.

Kryetari i Bashkisë- Përshëndetje të gjithëve! Për pjesën e manovratorëve dhe shoferave besoj një pjesë e tyre kapin një vlerë maksimale që është 51 000 lekë. Më shumë se aq nuk mund të rritet. Gjithshtu një pjesë e specilistëve tek agjencia e shërbimeve, le të themi që një pjesë e tyre janë drejtues duke marrë një punë të caktuar dhe drejtojnë pesë ose gjashtë punonjës të tjerë. Dhe atyre do ti rritet me 47 000 mijë lekë që është në kufirin maksimal. Specialist i lejeve ka që një punë të lehtë dhe pa ngarkesë prandaj është lënë në atë nivel. Pjesës se njësisë Administrative për një rritje si fillim me 14 000 mijë lekë është e pranueshme. Në janar do rishikohen përsëri. Mund ti çonim të gjitha maksimale po mundësitë e bashkisë nga ana financiare për momentin janë kaq. Unë mendoj që dhe në këto nivele që janë të kënaqshme. Sepse të rritet paga me 15 000 apo 30 000 është vlerë e konsiderueshme. Kështu që në janar do rishikohen pagat, me ardhjen e buxhetit të ri në janar do rishikohen dhe pagat dhe pozicionet të punës.

Albiona Lamaj – Shpresoj që vendet mos të jenë më vakant por me rritjen e pagave të plotësohen.

Eduart Faslliaj- Edhe pse materiali na erdhi pak me vonesë besoj se kryetari ishte shterues në fjalimin e tij. Edhe unë e përshëndes vendimin e qeverisë edhe pse pak i vonuar në rritjen e pagës gjithashtu edhe qëndrimin që ekzekutivi ka mbajtur për shtimin edhe më tepër të një pjesë të pagave të cilat mbulohen nga fondi i bashkisë. Efekti financiar nga cila datë fillon?

Kryetari i Bashkisë- Efekti financiar fillon nga data 1 Shtator.

Armand Ahmetaj – Nëse skemi diskutim tjetër unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e tetë Projekt-vendim “Për ndryshimin e vendimit nr. 74 datë 30.11.2023 “Mbi miratimin e nivelit të pagave të bashkisë, institucioneve në vartësi, njësisive administrative, dhe funksioneve të transferuara për vitin 2024”.

Këshilltarja Elmira Rama prezente në sallë.

Kush është dakord?

Miratohet me 16 vota pro,kundër ska, abstenim ska.

SEKRETARE


Refaela Xeba



Renshelo Shyreta
Eduardo Alisnongj
Eduart Faslliaj

KRYETAR

Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3570/3 Prot.

Patos më 04.10.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.09.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së nëntë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për një shtesë në VKB nr. 65 datë 17.09.2024 “Për miratimin e listës së familjeve në nevojë që përfitojnë rikonstruksion banese nga sistemi i pikëzimit”.

Kryetari i Bashkisë- Duke qënë se tek mbledhja e kaluar e këshillit kaluan banesat sociale ngeli një fond pa u plotësuar. Ne kemi dhe një banesë tjetër që është në Sheqishte që është futur te i njëjti fond. Procedura e prokurimit nuk është bërë ende që kështu kemi kohë për ta shtuar.

Arben Shpërdheja - Projekt-vendim “Për një shtesë në VKB nr. 65 datë 17.09.2024 “Për miratimin e listës së familjeve në nevojë që përfitojnë rikonstruksion banese nga sistemi i pikëzimit”.

Bazuar kërkesave të paraqitura nga qytetarët për rikonstruksion banese për familjet në nevojë, komisioni i strehimit pasi shqyrtoi kërkesat e paraqitura dhe dokumentacionin përkatës bëri vlerësimin për çdo dosje, sipas vendimit të K. Bashkiak me nr. 16, datë 29.02.2024 me nr. 497/2 prot., datë 07.03.2024, dhe miratoi listës emërore të familjeve përfituese sipas VKB nr. 65 datë 17.09.2024 si dhe tabelën përmbledhëse me vlerë prej 4,710,588.7 (katër milionë e shtatëqindë e dhjetë mijë e pesëqindë e tetëdhjetë e tetë pikë shtatë) lekë.

Vlera për rikonstruksion e banesave për vitin 2024 është miratuar me vendimin K. Bashkiak nr. 81 datë 18.12.2023 në programin buxhetor “Strehimi Social”, me zërin Rikonstruksioni i banesave të kushteve të papërshtatshme për familjet në nevojë”, në vlerën 5,153,623 (pesë milion e njëqind e pesëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e njëzet e tre) lekë.

Kjo vlerë është shpërndarë për rikonstruksionin e 12 (dymbëdhjetë) familjeve me preventiv të ndarë sipas kushteve të objektit përkatës. Preventivi i hartuar nga drejtoria për znj. Lutfije Grëmbi me vlerë 443,004.3 (katërqindë e dyzetë e tre mijë e katërpikë tre) lekë i shtohet tabelës përmbledhëse të VKB nr. 65 datë 17.09.2024.

Konkretisht në zërat e punimeve rikonstruksioni pjesëshëm për znj. Lutfije Grëmbi do të përfshihen këto punime; riparim çatie ekzistuese, ndërtim tavane, breza betoni she suvatime të pjesëshëm. Ky fond është parashikuar për blerje bazë materiale dhe punimet do të kryhen nga Agjencia e Shërbimeve Publike.

Lori Musaj- Edhe ky projektvendim kaloi në komisionin e ekonomisë dhe ne e kemi votuar pa asnjë ndryshim me katër vota pro. Ftoj kolegët ta miratojmë.

Albiona Lamaj- Për transparencë ky ishte rasti që solli dokumentat me vonesë kur diskutuam mbledhjen e kaluar? Jashtë afateve?

Arben Shpërdheja – Jo nuk ishte ky personi. Erdhi dhe një kërkesë tjetër, u panë të dyja kërkesat nga komisioni dhe u vlerësua të bëhet ky.

Armand Ahmetaj – Nëse s’kemi diskutim tjetër unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e nëntë Projekt-vendim “Për një shtesë në VKB nr. 65 datë 17.09.2024 “Për miratimin e listës së familjeve në nevojë që përfitojnë rikonstruksion banese nga sistemi i pikëzimit”.

Kush është dakord? Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 16 vota pro.


SEKRETARE




Refaela Xeba



KRYETAR

Armand Ahmetaj



Remalola Shyato 
Jeloudo Alishani 
Edwert Fesllig 



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3541 Prot.

Patos më 04.10.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.09.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së shtatë të rendit të ditës.

Në zbatim të ligjit nr. 68, 9936, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në njësitë vendore bashkia përpunon, përgatit dhe raporton me informacion këshillin bashkiak çdo 4-mujor të vitit aktual. Raporti monitorimit të zbatimit të buxhetit është përgatitur për periudhën janar-gusht 2024. Ky buxhet vazhdon të jetë një instrument kryesor për realizimin e qëllimit dhe orientimeve afatgjata të planifikuara nga bashkia. Ashtu siç kemi raportuar dhe në raportet e tjera burimet kryesore të buxhetit përbëhen nga :

1. Të ardhurat e veta
2. Transferta e pakushtëzuar
3. Transferta sektoriale

Nivelet nga 4-mujori i parë dhe sot nuk kanë ndryshuar të cilat janë sipas informacionit të detajuar. Përsa i përket realizimit janar-gusht në tabelën nr. 1 të materialit paraqitet realizimi i burimeve financiare.

Transferta e pakushtëzuar që përbën një nga burimet kryesore të buxhetit është 192 milion për vitin 2024 është shtuar nga fondet e trashguara me 70 milion dhe realizuar 199 242 000 ose 47%.

Realizimi i kësaj transferte është në këtë nivel sepse alokohet muaj për muaj nga pushteti qëndror. Po kështu ndodh dhe me transfertën sektoriale e cila në fillim të viti është alokuar 114,515,000 është shtuar me fondet e trashëguara me 44 milion dhe është realizuar 45%.

Të ardhurat vendore që përbëhen nga taksat dhe tarifat. Plani i miratuar 297 000, realizimi 44%.

Në total buxheti i Bashkisë Patos përbëhet nga burimet me vlerë 829,736,000 lekë ndërsa është realizuar 560,798,000. Dhe realizuar si shpenzime 333,663,000 lekë.

Ndryshimet që ka pësuar ky buxhet me VKB janar-gusht janë VKB nr. 32 ku është transferuar vlera për mbrojtjen civile për shtim të projektit për rrahabilitimin e perroit në lagjen e Re. Vendimi nr. 36 ku kemi një përdorim të fondit nga relaodi, gjate vitit ne kemi fituar një projekt për shërbimin e të moshuarëve dhe vlera e bashkëfinancimit është 922 milion dhe e kemi miratuar me VKB për mbulimin e këtij projekti. Kemi një vendim tjetër që ndryshon buxhetin gjatë kësaj periudhe duke bërë pakësimin e vlerës të projekti asfalto betoni me 3 000 000 lekë dhe e kemi përdorur për blerje bazës materiale me rërë bituminoze për qendren Siqecë në qendrën e Drenies. Gjithashtu kemi dhe projektvendimin ku nga nevojat dhe dëgjesat publike kemi miratuar me vendim përdorimin e fondit të miratuar për rrugën Gjinaoqarë 6 milion e 500 mijë për vitin 2024 dhe për ta realizuar më shpejt e kemi kaluar me bazë materiale asfalto beton.